

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Varret masive në Zubin Potok/ Kurti zbulon identitetin e tri prej viktimave
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/varret-masive-ne-zubin-potok-kurti-zbulon-identitetin-e-tre-prej-vik-i474637
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 14:04:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 13:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	618c760b753e93b671f859117549b4eb48b48d92212397b8d4d8e1ff58ae8ed2
TEKSTI	90e917bcc1689d52860444831ab56207c42c352142824241b61c8be3c6908b1e
PAMJA	2c11f8c2307a7219a873a090c3a5e42406dc7f547c59e6bbe07ff16634d20180

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9cdda2124d7833a4d81cbad79754a9adf7da467086399f3f4a9b924a070841e3
E MËPARSHMJA	8badec518f67113adfd619fe44f17810b0f2bc7d420cf6cfed320a454c800076
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9cdda2124d7833a4d81cbad79754a9adf7da467086399f3f4a9b924a070841e3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

16:25 Kuriozitete

Zemra fillon të rrahë fort, frymëmarrja shpejtohet, duart...

Varret masive në Zubin Potok/ Kurti zbulon identitetin e tri prej viktimave



19 Shtator 2026, 15:50, Kosova & Bota CNA



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar të shtunën se është konfirmuar identiteti i tri viktimave pas zhvarrimit të mbetjeve mortore të zbuluara në varreza masive në lokacione të ndryshme në veri të Kosovës.

Kurti shkroi në "Facebook" se raportet e ADN-së kanë konfirmuar se tri viktimat i përkasin grupit të njohur si "Grupi i Intelektualëve", kryesisht qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të rrëmbyer dhe të zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Grupi prej 23 "intelektualëve" ishte një grup shqiptarësh, mes tyre veprimtarë, profesionistë dhe figura publike nga zona e Mitrovicës, të cilët u zhdukën në zonën e Zubin Potokut më 19 prill të 1999-ës.

Kryeministri nuk tregoi me emër dhe mbiemër se kush ishin viktimat, por tha se familjet e tri viktimave të identifikuara janë njoftuar qysh sot.

Njoftimi i tij vjen gati dy muaj pasi u zbuluan tri varre masive në këtë komunë në veri të vendit, ku u gjetën mbetje mortore të së paku 23 njerëzve.

Në fund të muajit të kaluar, autoritetet kosovare i dërguan në Hagë të Holandës mostrat e mbetjeve mortore të zhvarrosura në lokacionet e varreve masive në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut.

Kurti tha se Kosova pret t'i pranojë edhe raportet e tjera për mostrat e dërguara për identifikim përmes analizës së ADN-së "në ditët dhe javët në vijim".

"Me shpresën që edhe familjet e tjera të marrin përgjigjet që presin prej 27 vitesh. Asnjë përgjigje nuk mund ta shuajë dhimbjen e humbjes, por njohja e së vërtetës i jep fund ankthit të pritjes për të mësuar fatin e më të dashurve", tha Kurti.

Varrezat në Zbui Potok u zbuluan rreth dy muaj më parë pas një hetimi dyvjeçar lidhur me dyshimet për krime lufte, sipas autoriteteve kosovare.


Prokuroria Speciale e Kosovës po i heton për këtë rast katër persona, J.R., M.J., R.K dhe M.B., të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile.

Që të katërt ndodhen në paraburgim. Njëri nga të arrestuarit, sipas autoriteteve, dyshohet se në kohën e luftës kishte qenë pjesë aktive e Armatës Jugosllave.

Sipas Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, 1.577 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-1999, ndërsa janë dokumentuar gjithsej 12.230 viktima të luftës.

Kosova ka kërkuar vazhdimisht nga Serbia bashkëpunim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe qasje në arkivat ushtarake që sipas autoriteteve mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme.

Kurti, i cili ndodhet në Shtetet e Bashkuara dhe për sesionin e 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, tha se do t'u kërkojë Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Europian dhe Britanisë së Madhe, ta shtojnë trysinë ndaj Serbisë për t'i zbatuar zotimet për hapjen e arkivave, për të ndihmuar në gjetjen e vendndodhjes së njerëzve të zhdukur nga lufta e fundit në Kosovë. /REL





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

[Ursula von der Leyen viziton Ballkanin/ Shmang Serbinë dhe Bosnjën](#)

[Qeveria gjermane i shpall luftë abuzimit me ndihmën sociale](#)

[Kanadaja dhe BE-ja, një vështrim në marrëdhënien e veçantë](#)

[SHBA-të dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksimin e saj](#)

[Donald Trump ndalon CNN dhe Politico të hyjnë në Shtëpinë e Bardhë](#)

[“Vendim tronditës”/ Avokati i Jakup Krasniqit: Dënimi i tij lidhet me postin politik](#)

[Macron: Sulmet hibride ruse kundër Evropës po intensifikohen](#)

[DW: Friedrich Merz, a do ta braktisë CDU-ja kancelarin?](#)

[Protesta globale, çmimet e karburanteve rriten për shkak të luftës SHBA-Iran](#)

[Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në veprimtari të paligjshme](#)

[OSBE-ja e gatshme të mbledhë votat në Kosovë për zgjedhjet serbe, pret miratimin e institucioneve të Kosovës](#)

[Policia nis operacionin për të larguar emigrantët nga plazhet e Ceutës](#)

[Deklarata e Marta Kos/ Avokati i Thaçit: Nuk të takon të paragjykosësh këtë çështje](#)

[Rusët votojnë në zgjedhjet e para parlamentare që nga nisja e pushtimit të Ukrainës më 2022](#)

[Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së](#)

[Mali i Zi me paga të reja nga janari, minimalja deri në 1600 euro](#)

Mbrojtja e ish-drejtuesve të UÇK-së është detyrë qytetare e institucionale

Mbreti Çarls paralajmëron për "rrezikun ekzistencial" të IA

Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës


U dënua me 25 vite burg në Hagë/ Reagon Thaçi: Do apeloj vendimin, mesazhi për qytetarët e Kosovës

[editorial](#)

15:14 Editorial

Katër burra që hynë në histori dhe një kryetar bashkie që nuk di të dalë nga karrigia

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

11:47 Opinione Luciano Boçi

TË RROFTË EMRI...

21:11 Opinione Lutfi Dervishi

Orët e Tiranës

17:02 Opinione Belind Këlliçi

Bëhu si Roni të kesh sukses në Shqipëri!

Lifestyle

07:38 Lifestyle

Nga Europa në SHBA/ Ja cilat janë qytetet më të mira të botës

Qytetet evropiane dhe të Amerikës së Veriut dominojnë Inde...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.